

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Matura 2021

UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E PËRGJIGJEVE TË NXËNËSVE

SESIONI I

LËNDA: GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Varianti A

Gjinnazi dhe gjinnazi gjuhësor

Udhëzime të Përgjithshme

Në testin e gjuhës shqipe dhe letërsisë përdoren dy lloje pyetjesh, të cilat vlerësojnë kompetencat e të nxënësve për secilin nxënës. Një nga llojet është pyetja me alternativa, ku nxënësit do të zgjedhin atë alternativë që i përgjigjet pyetjes. Çdo pyetje e këtij lloji ka një përgjigje të vetme të saktë. Përgjigjet e pyetjeve me alternativa do të vlerësohen në mënyrë elektronike.

Lloji tjetër i pyetjeve është ai me shtjellim, ku nxënësi e shkruan përgjigjen në hapësirën e përcaktuar në test. Këto pyetje vlerësohen nga vlerësuesi, të cilët do të përdorin udhëzimet e pikëzimit të përshkruara në vijim të këtij manuali.

Qëllimi i këtij materiali është të sigurojë për vlerësuesit informacionin dhe udhëzimet për shpërndarjen e pikëve, të nevojshme për të caktuar në mënyrë të besueshme dhe të vlefshme vlerësimin e përgjigjeve të secilit nxënës.

Secila prej pyetjeve me shtjellim ka një vlerë pikësh prej 1 (një), 2 (dy) ose 3 (tre) pikë, në varësi të thellësisë së të kuptuarit ose shkallës së mbështetjes tekstuale që kërkon pyetja.

Udhëzuesi i pikëzimit përshkruan aspekte të veçanta të përgjigjes për çdo pyetje. Secila pyetje e testit ka udhëzuesin e vet, të përshtatur për elemente specifike të saj. Megjithatë ekzistojnë disa pika të përbashkëta tek të gjithë udhëzuesit. Për shembull, niveli më i ulët i pikëve, në secilin udhëzues, është 0 pikë. Në këtë rast përgjigjja e dhënë dëshmon se nxënësi nuk ka kuptuar një aspekt të caktuar të tekstit që po vlerësohet nga pyetja. Përgjigjet që marrin një vlerësim me 0 pikë, mund tregojnë se teksti ose pyetja janë kuptuar keq, ose ato përfshijnë informacione aq të paqarta, sa vendosja e një pike më të lartë nuk mund të justifikohet.

Në test ka pyetje ku nxënësit do të përgjigjen në mënyra të ndryshme. Prandaj, do të ishte e papërshtatshme që të vendoset në udhëzues një përgjigje specifike, unike, që pritet të japin në test të gjithë nxënësit. Është përgjegjësia e vlerësuesit dhe më pas e komisionit të vlerësimit, që të marrë parasysh përgjigjen që nxënësi ka dhënë, dhe ta vlerësojë atë si të plotë, të pjesshme apo të pasaktë.

Në testin e gjuhës shqipe dhe letërsisë idetë e dhëna nga nxënësit dhe larmia e interpretimeve që ata sjellin për secilën pyetje, çon në shumë përgjigje të paparashikueshme. Udhëzuesi i pikëzimit dhe shembujt e dhënë në të duhet të jenë gjithmonë baza për secilin vendim që komisioni i vlerësimit do të japë. Megjithëse ne i inkurajojmë vlerësuesit që t'i lexojnë përgjigjet e nxënësve në mënyrë mbështetëse, domethënë që mund të lejojnë gabime të vogla ose mungesë qartësie, është e domosdoshme që vlerësuesit të mos interpretojnë mbi përgjigjet e dhëna nga nxënësit. Ata nuk duhet të supozojnë se çfarë donte të thoshte nxënësi në përgjigjen e tij. Vlerësuesit duhet ta vlerësojnë secilën përgjigje të nxënësit sipas përgjigjes konkrete që ka dhënë ai. Në fund të fundit, kjo është mënyra më e drejtë, e besueshme dhe e vlefshme për pikëzimin e përgjigjeve të nxënësve për këto lloje pyetjesh.

Pjesa I – Gjuhë shqipe

Orientimi për të ardhmen

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë

Pyetja 5 2 pikë

Në *paragrafin e parë* identifikoni dy informacione të vlefshme që ka marrë autori gjatë takimeve informuese.

2 pikë: Përgjigje e plotë
Përgjigjja identifikon dy informacione nga lista e mëposhtme. Informacionet mund të merren drejtpërdrejt nga teksti ose të perifrazohen.
Shembuj:
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Planifikimi është ide e mençur.</i> • <i>Javët e para të një semestri vendosin se si do të shkojë pjesa tjetër e vitit.</i> • <i>Përgatitja për një test është shumë më e frytshme nëse shtrihet në kohë.</i> • <i>Të mos studiojmë një natë para provimit.</i>
1 pikë: Përgjigje e pjesshme
Përgjigjja jep vetëm një nga informacionet e listuara më lart.
0 pikë: Përgjigje e papranueshme
Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.

Pyetja 6 **1 pikë**

Pse Da Vinçi nuk e kufizoi veten në një fushë të vetme studimi?

1 pikë: Përgjigje e plotë
<p>Përgjigjja tregon se Leonardo Da Vinçi kishte <i>një imagjinatë</i> që nuk e lejoi të kufizohej vetëm në një fushë studimi OSE thekson se Da Vinçi ishte i zoti në shumë fusha të dijes.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none">• <i>Da Vinçi nuk e kufizoi veten në një fushë studimi, për shkak të imagjinatës së tij të pakufishme.</i>• <i>Kishte një imagjinatë të paanë.</i>• <i>Ishte i zoti në shumë fusha, ndaj nuk u përqendrua vetëm në një të njërën nga ato.</i>• <i>Imagjinata e tij nuk kufizohej dot.</i>
0 pikë: Përgjigje e papranueshme
<p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p>

Pyetja 7 2 pikë

Ç'pasoje do të kishin nxënësit, nëse do të përqendroheshin vetëm në një lëndë?

Cili është propozimi që bën autori për ta zgjidhur atë?

<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja identifikon një nga pasojat që do të kishin nxënësit nëse do të përqendroheshin vetëm në një lëndë.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ngushtohet vizioni i tyre.</i> • <i>Kufizohet zhvillimi i individit.</i> • <i>Kufizohet imagjinata.</i> • <i>U shkakton mundim për të planifikuar jetën e tyre.</i> • <i>Fiksohen pas kësaj ideje dhe lënë mënjanë zhvillimin.</i>
<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja tregon propozimin që bën autori për ta zgjidhur atë.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Të përmirësojmë njohuritë tona, duke zgjeruar dijen përmes fushave të tjera.</i> • <i>Të marrim pjesë edhe në fusha të tjera.</i> • <i>Të ndjekim edhe fusha të tjera.</i> • <i>Të zgjerojnë horizontin e tyre.</i> • <i>Nuk duhet të kufizohen në zgjedhjen e një fushe.</i> • <i>Të ndryshojmë vizionin tonë për të ardhmen.</i>
<p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p>

Pyetja 8 2 pikë

Interpretoni çfarë ka të veçantë, në aspektin *stilistikor*, zgjedhja e fjalëve nga ana e autorit, për të paraqitur idenë e tij.

Ajo u shkakton nxënësve aq shumë mundim për të planifikuar jetën e tyre pas përfundimit të shkollës, saqë çdo gjë në shkollë duket sikur është e mbërthyer pas saj.

<p>2 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja tregon se nxënësi bën lidhjen midis idesë dhe mënyrës së veçantë që zgjedh autori për ta paraqitur atë. Në përgjigje duhet të bëhet lidhja midis përpyekjeve të mundimshme për të planifikuar të ardhmen dhe fjalëve që zgjedh autori për ta paraqitur atë (në këtë rast fjalët-mundim, çdo gjë dhe metafora-mbërthyer pas saj).</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zgjedhja e fjalëve (metafora ose sendërzimi “<i>mbërthyer pas saj</i>”) sugjeron pikërisht ankthin, mundin që përjetojnë nxënësit për të planifikuar të ardhmen e tyre. Të gjithë në shkollë mendojnë vetëm për planifikimin dhe asgjë tjetër. • Duket sikur jeta në shkollë (çdo gjë) është përqendruar vetëm te planifikimi i së ardhmes. Fjala mundim dhe metafora: mbërthyer pas kësaj, sugjerojnë pikërisht këtë ankth që ka kapur çdo nxënës të shkollës, në këtë situatë. • Nëpërmjet përdorimit të togut “<i>mbërthyer pas saj</i>” (në përdorim metaforik), fjala peshon më fort dhe krijon vërtet imazhin e një mundimi të madh, që ka përfshirë nxënësit.
<p>1 pikë: Përgjigje e pjesshme</p> <p>Përgjigjja shpjegon idenë e fjalisë së dhënë, pa kaluar në nivel interpretimi, pa bërë lidhjen midis mundimit dhe fjalëve që zgjedh autori (në përdorim metaforik), për ta dhënë atë.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Diplomimi shkakton mundim të madh te nxënësit. • Gjatë gjithë periudhës së shkollës së mesme, ata orientohen me mundim vetëm drejt planifikimit të së ardhmes.
<p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p>

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur, në përgjigjen e dhënë, jep një formulim të ndryshëm nga modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 9 2 pikë

Në *paragrafin e tretë* veçoni argumentin në mbështetje të tezës që mbron autori, bashkë me shembullin ilustrues.

1 pikë: Përgjigje e plotë
<p>Përgjigjja tregon argumentin që autori parashtron, për të mbështetur opinionin e tij.</p> <p><u>Argumenti:</u></p> <p>Shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Arsimimi duhet të jetë pjesë e jetës sonë edhe pas mbarimit të shkollës, si dhe duhet të jetë shumë më i gjerë nga sa e imagjinojmë.</i>
1 pikë: Përgjigje e plotë
<p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Leonardo Da Vinçi,</i> • <i>Leonardo,</i> • <i>Da Vinçi.</i>
0 pikë: Përgjigje e papranueshme
<p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> <p>Nëse nxënësi identifikon shembullin, por pa dhënë argumentin.</p>

Pyetja 10 (a) 1 pikë

Cili është qëllimi i përdorimit të thonjzave në fjalinë e mëposhtme?

Unë mendoj se ata që zgjedhin të specializohen në një fushë të caktuar, nuk do të përfitonin nga ajo çfarë ekziston përtej kufijve të “fushave tona të studimit”.

1 pikë: Përgjigje e plotë

Përgjigjja tregon se përdorimi i thonjzave në një fjali bëhet për të tërhequr vëmendjen e lexuesit, në lidhje me: përdorimin e një termi;

OSE përmbush një qëllim të autorit, duke ilustruar idenë që ai kërkon të shprehë;

OSE kemi një përdorim të caktuar gjuhësor, ku shfaqet një ngarkesë e caktuar emocionale.

Shembuj:

- *Veçon grupin e lëndëve që e kufizon zhvillimin e individit. (qëllim)*
- *Duket sikur thonjzat grafikisht kufizojnë termin, gjë që përkon me idenë e kufizimit të horizontit të dijeve. (qëllim)*
- *Ironizon të ashtuquajturat fusha tona të studimit. (përdorim gjuhësor: ironi)*
- *Përdor terminologji të huazuar nga kurrikula. (përdorim gjuhësor: term)*

0 pikë: Përgjigje e papranueshme

Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.

- *Sjell në fokus (e paplotë)*
- *Sjell në fokus fushat e studimit. (e paqartë)*
- *Thekson (e paplotë)*

Pyetja 10 (b) 2 pikë

Pse autori ka zgjedhur që argumentin e tij ta mbështetë me fakte dhe me përvoja personale? Shpjegoni përgjigjen tuaj për secilin rast.

<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p><u>Fakte:</u></p> <p>Përgjigjja thekson se faktet lidhen me prova, dëshmi që kanë besueshmëri të plotë, janë pranuar dhe miratuar nga të gjithë.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Faktet janë të pakundërshtueshme, të provuara, të miratuara nga të gjithë. • Përdorimi i fakteve e bën tekstin më bindës. • I jep objektivitet tekstit.
<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p><u>Përvoja personale:</u></p> <p>Përgjigjja thekson se teksti orientohet drejt subjektivitetit. Autori ndikon në ndjeshmërinë e lexuesit, si dhe në opinionin e tij, në përputhje me qëndrimin që mban ndaj argumentit.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • E bën më të afruar me lexuesin. • Shembujt personalë bëjnë që lexuesi të ndikohet më shumë. • Krijon afritet, pasi duket sikur ndajnë të njëjtat shqetësime. • I jep subjektivitet. • Që të jetë bindës, teksti mbështetet edhe në fakte të pakundërshtueshme, edhe në përvoja personale.
<p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p>

Pinguinët

Pyetja 11	B	1 pikë
Pyetja 12	D	1 pikë
Pyetja 13	B	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	D	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	C	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë
Pyetja 19	A	1 pikë
Pyetja 20	C	1 pikë

Pjesa II- Letërsi

De Rada - Këngët e Milosaos

Pyetja 21 B 1 pikë

Pyetja 22 A 1 pikë

Pyetja 23 D 1 pikë

Pyetja 24 (a) 1 pikë

Në këtë fragment, Milosao i kërkon Rinës ujë, për të shuar etjen. A mendoni se kjo është arsyeja e vërtetë e këtij takimi?

<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja thekson JO dhe shpjegon arsyen e vërtetë të takimit, që është dëshira e Milosaos për t'u takuar me të dashurën.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Milosao kërkon ujë; në nëntekst, është i djegur jo nga etja, por nga dashuria.</i> • <i>Milosao kërkon ujë, jo se është thjesht i etur për ujë, por është një arsye për t'u takuar me të dashurën.</i> • <i>Janë ende në fillim të lidhjes dhe Milosao kërkon pretekst për t'u takuar me të.</i> • <i>Vepra është e ndikuar nga folkori, ku takimi i të dashurve te burimi është tipik; në këtë rast, vendtakimi i të rinjve nuk është burimi, por është i pranishëm uji, etja, si pretekst për t'u takuar.</i>
<p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja qarkon PO dhe thekson në mënyrë të drejtpërdrejtë atë që duket në planin e parë.</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Po, atë vërtetë e ka djegur etja.</i> • <i>Po, ai do të pijë ujë dhe të flasë pak me të (e paqartë arsyeja e vërtetë).</i> • <i>Po, ai shkon atje (e paqartë).</i>

Pyetja 24 (b)**1 pikë**

Identifikoni vargun që zbulon në **mënyrë të drejtpërdrejtë** lidhjen shpirtërore të të rinjve.

1 pikë: Përgjigje e plotë
Përgjigjja identifikon vargun e duhur në fragment. Shembull: <ul style="list-style-type: none">• <i>Ata duheshin e s'e thoshin.</i>
0 pikë: Përgjigje e papranueshme
Përgjigjja mund të identifikojë një varg tjetër, mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.

QSHA 2021

Pyetja 25 2 pikë

Cila është figura e stilistikës që krijohet nga mungesa e foljes në vargun e mëposhtëm?

Shpjegoni efektin që krijon te lexuesi ky lloj organizimi i vargut.

<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p>
<p>Përgjigjja identifikon <i>elipsën</i> si figurën e krijuar nga mungesa e foljes.</p> <p>Shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>elipsa</i>
<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p>
<p>Përgjigjja <i>shpjegon</i> efektin që krijon ky organizim vargu, duke theksuar se mungesa e foljes do të thotë mungesë veprimi. Kjo mungesë thekson detaje të tjera te lexuesi.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Shmanget veprimi, orientohet lexuesi te vajza dhe detaji pamor (buzët), shumë sensual dhe plot nëntekst (buza në gaz).</i> • <i>Sigurohet lakonizmi (përgjigje minimale, por e pranueshme).</i> • <i>Përqendrohet te më thelbësorja, buzëqeshja e vajzës.</i> • <i>Përqendrohet te pamja (element fizik) dhe jo veprimi.</i> • <i>Ndihmon në qartësinë e imazhit që kërkon të nxitë autori dhe, në këtë rast, te vajza që buzëqesh.</i>
<p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p>
<p>Çdo figurë tjetër stilistike.</p> <p>Shpjegimi i dhënë nuk merr për bazë efektin që krijon mungesa e foljes në varg te lexuesi.</p> <p>Nëse zhvillon një shpjegim, por nuk e ka gjetur figurën ose e ka gjetur gabim atë.</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ajo është e buzëqeshur.</i> • <i>Kemi një vajzë të lumtur.</i> • <i>Poeti na tregon për një vajzë të lumtur, të qeshur (e paqartë).</i>

Pyetja 26 (a)**2 pikë**

Vargu: *Ç'ke që po ikën si era?* ndërtohet mbi figurën e krahasimit.

Interpretoni imazhin e përfutur nga përdorimi i kësaj figure, parë në kontekstin e të gjithë fragmentit.

<p>2 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja jep një këndvështrim personal të nxënësit në lidhje me mënyrën se si e kupton nëntekstin që mbart vargu. Në të duhet të theksohet thelbi i krahasimit: kur është me njeriun që do, koha ikën po aq shpejt sa edhe era;</p> <p>OSE tonet qortuese të vajzës kundrejt djalit, ikja e të cilit i duket e shpejtë, <i>si era</i>.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Krahasimi me shpejtësinë e erës dëshmon se në sytë e vajzës koha që kalon me të dashurin, fluturon shumë shpejt, si era.</i> • <i>Duket se vajza dëshiron të zgjatë qëndrimin me të dashurin, por sado që ta zgjatë atë, koha kurrë nuk do të mjaftojë.</i> • <i>Ka një lloj qortimi në fjalët e saj: ai po rri pak. Kjo nuk mjafton për vajzën.</i> • <i>Krahasimi me erën është tipik popullor. Koha ikën shpejt, nuk ndihet, ajo vrapon si era.</i>
<p>1 pikë: Përgjigje e pjesshme</p> <p>Përgjigjja shpjegon idenë e vargut të dhënë, pa kaluar në nivel interpretimi.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Koha me të dashurin ikën shpejt.</i> • <i>Ajo s'e kupton si ikën koha kaq shpejt.</i>
<p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p>

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur, në përgjigjen e dhënë, jep një formulim të ndryshëm nga modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 26 (b) 2 pikë

Si ndryshon veta e komunikimit në dy vargjet e fundit? Cili është raporti që krijohet mes narratorit dhe lexuesit në këtë rast?

<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja tregon kalimin nga veta III në II shumës.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kalohet nga veta III në II shumës.</i> • <i>Kalohet në vetën II shumës.</i>
<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja shpjegon raportin e krijuar, ku theksohet lidhja e drejtpërdrejtë midis lexuesit dhe narratorit.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Autori krijon një komunikim më të drejtpërdrejtë me lexuesin.</i> • <i>E bën lexuesin pjesëmarrës në subjektin e veprës.</i> • <i>Tërheq më shumë interesin e lexuesit.</i> • <i>Duke e përfshirë, ndikon më shumë te mbresat e lexuesit.</i>
<p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p>

Pyetja 27 2 pikë

Komentoni mënyrën se si është bërë portretizimi i Rinës. Në përgjigjen tuaj mund të përqendrohesh në tiparet fizike ose në tiparet e karakterit të personazhit.

<p>2 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja përqendrohet në mënyrën se si është bërë përshkrimi fizik, duke theksuar detajet tipike që krijojnë përfytyrime të lexuesit. Komenti duhet të shoqërohet me të paktën dy detaje të paraqitjes fizike dhe figurën stilistike që mbështet këtë përfytyrim: epitetin apo metoniminë.</p> <p><u>Portretizimi fizik:</u></p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Poeti është i kursyer në paraqitjen fizike të vajzës. Është shumë sintetik, kap pak detaje domethënëse, por që ngacmojnë përfytyrimin: flokët dhe veshi i bardhë. Epiteti i bardhë krijon përfytyrimin e diçkaje të pastër, të panjollë. Ndërsa flokët, të cilat janë gërshet, që ajo e thur dhe shtur, krijojnë tek lexuesi imazhin e një loje nazike. • Rina paraqitet si një vajzë e bukur - vargu i tretë. Poeti përqendrohet në dy detaje sensuale: flokët dhe veshi. Flokët gërshet (sipas përfytyrimit popullor) dhe veshi i bardhë (epitet). • Edhe pse në pak rreshta, sërish mund të përfytyrojmë një vajzë të bukur, ndoshta delikate, me pak detaje që theksojnë lehtëzi portretin e saj fizik, siç janë flokët, veshi. Vajza paraqitet me një portret të qeshur. Edhe figuracioni shfaqet i kursyer, ka vetëm një epitet (i bardhë). • Ana shpirtërore reflektohet edhe në portretin fizik të vajzës. Ajo është me buzë në gaz dhe çeret të ndezur, pasi është e lumtur, është e dashuruar. • Përfytyrimi për vajzën vjen në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet metonimisë e bukura, që përmbledh në të vërtetë edhe bukurinë fizike, edhe atë shpirtërore.
<p>1 pikë: Përgjigje e pjesshme</p> <p>Përgjigjja vijëzon një portret fizik të përgjithshëm të vajzës, pa dhënë detaje mbështetëse apo figurat stilistike si epiteti ose metonimia.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ajo është dhënë tepër sensuale, përmes detajeve shqisore. • Poeti jep pak detaje të portretit fizik, si p.sh. flokët. • Poeti paraqet flokët dhe veshin e bardhë.
<p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p>

Vazhdim

<p>2 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja përqendrohet në mënyrën se si autori bën përshkrimin e karakterit, duke theksuar detajet tipike që krijojnë përfytyrime të lexuesi. Komenti duhet të shoqërohet me të paktën dy detaje të paraqitjes shpirtërore dhe figurën stilistike që mbështet këtë përfytyrim: <i>metaforën, ose epitetin, ose metoniminë.</i></p> <p><u>Portretizimi shpirtëror:</u></p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Autori mbetet lakonik në përshkrimin e Rinës, si një vajzë e dashuruar dhe plot ndjenja, të cilat nuk mund t'i fshehë dot. Ajo është e ndrojtur, megjithatë është e para që nis dialogun. Ajo flet me buzë në gaz (frazologjizëm- dashuria e bën të lumtur). Asaj i duket i shkurtër takimi me të dashurin. Fytyra e saj është e ndezur (çehrja e ndezur- metaforë dhe epitet). Ajo e shfaq dukshëm, pavarësisht se mundohet ta fshehë, se ardhja e të dashurit e lumturon, e gëzon. Ajo i ka ruajtur dy mollë, si shenjë e vëmendjes së saj ndaj Milosaos.</i> • <i>Rina mezi e pret Milosaon, e mendon gjatë atë. Shfaqet edhe me naze, delikate (shpleks gërshetin). Ajo po jeton gjendjen e një dashurie shumë të fortë, gjë që e paraqet çehrja e ndezur e saj (metaforë).</i> • <i>Përfytyrimi për vajzën vjen në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet metonimisë e bukura, që përmbledh në të vërtetë edhe bukurinë fizike, edhe atë shpirtërore.</i>
<p>1 pikë: Përgjigje e pjesshme</p> <p>Përgjigjja vijëzon një portret shpirtëror të përgjithshëm të vajzës, pa dhënë detaje apo figura stilistike.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ajo shfaq ndjenja delikate.</i> • <i>Shfaqet me naze.</i> • <i>Shfaqet e dashuruar.</i> • <i>Rina është plot me ndjenja.</i> • <i>Shfaqet e e lumtur (flet me buzë në gaz).</i>
<p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p>

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur, në përgjigjen e dhënë, jep një formulim të ndryshëm nga modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Balzak- Xha Gorioi

Pyetja 28	D	1 pikë
Pyetja 29	C	1 pikë
Pyetja 30	B	1 pikë

Pyetja 31 (a) 2 pikë

Cila është gjendja shpirtërore e xha Gorioit në fragment? Çfarë e ka shkaktuar atë?

1 pikë: Përgjigje e plotë

Përgjigjja tregon gjendjen shpirtërore të Gorioit, e cila në thelb është **e lumtur**. Nxënësi mund të identifikojë një rast nga lista më poshtë apo një sinonim me të.

Gjendja shpirtërore:

Shembuj:

- *i lumtur,*
- *i entuziazmuar,*
- *euforik,*
- *i ngazllyer,*
- *i gëzuar,*
- *i realizuar,*
- *i përmbushur.*

1 pikë: Përgjigje e plotë

Përgjigjja tregon arsyen e kësaj gjendjeje, që lidhet me lumturinë e së bijës, e cila në këtë moment po martohet me Rastinjakun;

OSE me faktin se ai do të jetë më pranë së bijës.

Arsyeja:

Shembuj:

- *Ai realizon ëndrrën për të martuar të bijën me Rastinjakun, të cilin e vlerëson si të denjë.*
- *E bija po martohet me Rastinjakun, të cilin ai e vlerëson shumë.*
- *Martesa e dy të rinjve (përgjigje minimale, por e pranueshme).*
- *Ai është i lumtur se e bija është e lumtur.*
- *Ai shpreson se do të ketë mundësinë, që, pas kësaj martese, jo vetëm Delfina, por edhe vetë ai do të jetë më i lumtur, pasi do të ketë mundësinë ta takojë atë më shpesh.*
- *Ai do të ketë mundësinë ta takojë atë më shpesh. Kjo e lumturon.*

0 pikë: Përgjigje e papranueshme

Përgjigjja identifikon një gjendje shpirtërore të personazhit që dëshmon se nxënësi nuk e ka kuptuar kontekstin në të cilin zhvillohet ngjarja në këtë fragment.

Shembuj:

- *Ai ndihet i lumtur se ka të bijën pranë. (e paqartë)*
- *Ai ndihet i lumtur se shikon të bijën. (jashtë kontekstit)*
- *Ai është i gëzuar se e bija është e bukur. (e pavend)*

Përgjigjja jep gabim gjendjen shpirtërore ose nuk e përcakton fare atë, por paraqet një nga arsyet.

Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.

QSHA 2021

Pyetja 31 (b)

2 pikë

Çfarë vlerëson xha Gorioi te vajza e tij? Mbështeteni idenë tuaj me detaje nga fragmenti.

<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja tregon se Gorioi vlerëson vetëm bukurinë tek vajza e tij.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson bukurinë, • bukurinë, • hijeshinë e saj, • nurin e saj, • pamjen e jashtme fizike, • aspektin fizik.
<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja jep të paktën dy detaje nga lista e dhënë më poshtë për të mbështetur idenë.</p> <p><u>Detaje:</u></p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Sa e bukur që është, hë?</i> • <i>me një nur të tillë e me këtë gropëzë në faqe?</i> • <i>S'keni parë, hë?</i> (nënkuptohet) • <i>këtë engjëllushe (në nëntekt kuptohet se është e bukur)</i> • <i>do të bëhet njëmijë herë më e bukur.</i>
<p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja nuk tregon se Gorioi vlerëson vetëm bukurinë tek vajza e tij ose nuk jep përgjigje fare, por jep detaje.</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p>

Pyetja 32 **1 pikë**

Cila është ndjesia që provon Eugjeni për xha Gorioin? Identifikojeni atë, bashkë me një shembull ilustrues.

<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja përcakton ndjesinë që provon Eugjeni, e cila është adhurim.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>adhurim,</i> • <i>nderim,</i> • <i>përrulje,</i> • <i>admirim,</i> • <i>respekt,</i> • <i>përdëllim.</i>
<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja e dhënë në pjesën e parë të pyetjes mbështetet me një shembull ilustrues nga paragrafi I.</p> <p><u>Ilustrimi:</u></p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>adhurimin e padjallëzuar</i> • <i>Eugjeni kishte ngjirë</i> • <i>me një drithërim të shenjtë.</i> • <i>Do të jem i denjë për të gjitha këto, - thirri ai.</i>
<p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>besnikëri (e pavend: kjo lidhet me raportin e Gorioit me të bijat)</i> • <i>dashuri vetëmohonjëse (e pavend: kjo lidhet me raportin e Gorioit me të bijat)</i>

Pyetja 33 **3 pikë**

Zbuloni çiftin e fjalëve që krijon *kundërvënien* në fjalinë e mëposhtme.

Nisur nga i gjithë fragmenti, interpretojeni këtë kundërvënie, duke e lidhur me thelbin e figurës së xha Gorioit.

<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja tregon të <i>vetmin</i> çift fjalësh që krijojnë kundërvënie.</p> <p>Shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>skëterrë-parajsë.</i>
<p>2 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja jep një interpretim personal të nxënësit, që dëshmon zërthimin e nëntekstit që mbart çifti i fjalëve në këtë fjali, parë në kontekstin e të gjithë fragmentit.</p> <p><u>Interpretimi:</u></p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Në këtë moment ai po përjeton parajsën, që përfitohet si kulmi i paqes dhe i lumturisë nga ana e tij. Përpara kësaj lumturie maksimale që ai po ndien, e cila lidhet me pasionin e çmendur që ai ka për të bijën, pak rëndësi ka se çfarë mund të provojë në botën e përtejme, qoftë edhe ferri. Ferri nuk mund të jetë më i rëndë për të, sesa vuajtja që mund të provojë në tokë, nëse humbet dashurinë e së bijës apo konstaton se ajo nuk është e lumtur.</i> <p>OSE</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Pasioni i sëmurë i Gorioit është dashuria për vajzat (për Delfinën në rastin konkret). Për këtë shkak, ai është gati të kryejë sakrificën më sublime, të pranojë edhe ferrin. Ai nuk ka frikë nga ajo që i vjen pas vdekjes, sepse mundimi që ka provuar për të fituar dashurinë e Delfinës, ka qenë shumë herë më i madh sesa mundimet që mund të heqë në botën e përtejme.</i> <p>OSE</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Gorioin nuk e tremb skëterra në këmbim të dashurisë së vajzave. Përballë dashurisë së Delfinës, pushteti i parajsës bie.</i> • <i>Ai nuk e ka frikë ferrin, sepse ka qenë më e rëndë se ferri, vuajtja që ka kaluar në tokë dhe dashuria e vajzës i ka dhënë atij parajsën.</i>

1 pikë: Përgjigje e pjesshme

Përgjigjja nuk jep një interpretim të plotë. Ajo përqendrohet vetëm në njërin nga fjalët dhe e zbërthen atë.

Shembuj:

- *E konsideron lumturinë e tanishme si parajë.*
- *Para kësaj lumturie, ferri nuk është asgjë.*
- *Ai nuk e ka frikë ferrin, sepse ka qenë më e rëndë se ferri, vuajtja që ka kaluar në tokë.*

0 pikë: Përgjigje e papranueshme

Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.

Shembuj:

- *E barazon me parajsën. (e paqartë)*
- *Jeta e tij është si parajsë. (e paqartë)*
- *Nuk e ka frikë ferrin. (e palotë)*
- *Nuk beson në ferr-parajsën. (e pavend)*
- *Parajsa është për njerëzit e mirë dhe skëterra për mëkatarët. (jashtë kontekstit)*
- *Vajza e tij është si parajsa për të, por ai është në ferr. (e pavend)*
- *Xha Gorioi është i gatshëm të falë parajsën për hir të dashurisë për të bijën. (përsërit trungun e pyetjes)*

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur, në përgjigjen e dhënë, jep një formulim të ndryshëm nga modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 34 **2 pikë**

Bazuar në **dy paragrafët** e fundit të fragmentit, zbuloni një cilësi të karakterit të Delfinës.

Pse mendoni se kjo është cilësia që e karakterizon atë? Jepni një detaj apo shprehje që mbështet përgjigjen tuaj.

<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja identifikon një cilësi të karakterit të Delfinës nga lista e dhënë më poshtë ose të ngjashme me shembujt në këtë listë.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>egoiste,</i> • <i>cinike,</i> • <i>e ftohtë,</i> • <i>mosmirënjohëse,</i> • <i>përllogaritëse,</i> • <i>arrogante,</i> • <i>përçmuese,</i> • <i>e përkëdhelur.</i>
<p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja shpjegon se pse nxënësi mendon që kjo cilësi e karakterizon Delfinën. Përgjigjen do ta mbështetë edhe me detaje nga dy paragrafët e fundit të fragmentit.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Fakti që Gorioi i lutet, përgjërohet që ajo ta takojë, dëshmon se është natyrë e ftohtë, mosmirënjohëse, e përkëdhelur, egoiste.</i> • <i>Fjalët që ajo i thotë Eugjenit për të atin, dëshmojnë përçmim, cinizëm, bezdisje, nënvleftësim.</i> • <i>Ka një përputhje midis fjalëve të Gorioit (Premtomë që do të vish, thuamë....) dhe fjalëve të saj në fund (Do të na bezdisë ngandonjëherë), që bëjnë që ky tipar i saj të jetë sundues.</i> • <i>Lutja, fjalët gjithë përgjërim që Gorioi i drejton së bijës, dëshmojnë pikërisht natyrën e saj të ftohtë.</i> <p><u>Detaje apo shprehje</u> (të përdorura gjatë shpjegimit):</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Premtomë që do të vish, thuamë....</i> • <i>sa të lumtur do të më bëje me diçka që s'të kushton asgjë!</i> • <i>vetëm një hap do të bësh</i> • <i>Do të na bezdisë ngandonjëherë</i>
<p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja jep një shpjegim, por nuk identifikohet qartë tipari karakterizues i personazhit. Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p>

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur, në përgjigjen e dhënë, jep një formulim të ndryshëm nga modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 35 **8 pikë****Lloji i esesë: argumentuese**

Për vlerësimin e përgjigjeve për pyetjen ese do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton nevojën *për të zgjeruar horizontin në mënyrë që të jemi pjesë e botës*;
- zbërthen argumentet e dhëna përmes **detajesh** të shumëllojshme shpjeguese dhe përshkrimi mbështet shpjegimin përgjatë gjithë shtjellimit;
- përdor referenca bindëse, të mbështetura në burime të shumëllojshme informacioni, të pavarura nga njëra-tjetra;
- sjell përvoja të ndryshme personale, të cilat mbështetin bindshëm argumentin;
- paraqet qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- planifikon me shumë kujdes **hyrjen** (e cila i shmanget së zakonshmes) dhe siguron **kalimin rrjedhshëm** në paragrafët zhvillues;
- parashtron qartë qëndrimin e tij në raport me nevojën (**ose jo**) për të zgjeruar horizontin dhe për t'u bërë natyrshëm pjesë e botës;
- mund të paraqesë (**ose jo**) kundërteza (dhe kundërargumente), në varësi të teknikës së argumentimit, por paragrafët zhvillues duhet të shtjellojnë në mënyrë të plotë, nëpërmjet teknikash shumë të zgjedhura, aspekte të veçanta të temës;
- grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme;
- zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme;
- përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përdor një gjuhë shumë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një përshtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën;
- përdor një gjuhë **tipike argumentuese**, të pasur me detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit;
- përdor gjuhë subjektive dhe shpesh format shpjeguese gërshetohen me detaje përshkruese;
- përdor fjalor shumë të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim shumë të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**2 pikë****(sintaksa dhe drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan saktë nga pikëpamja e *drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit*, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive;
- përdor drejt struktura *të thjeshta e të ndërlikuara të fjalive*, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e esesë;
- shkruan pa gabime fjalë të përdorimeve të shpeshta (ose jo), si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive;
- përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj, gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Shënim:

Për të katër kriteret e paraqitura më sipër, nëse përgjigjet janë të pjesshme, nxënësi do të marrë **1 pikë**.

Nëse nxënësi ka shkruar një lloj tjetër eseje (jo argumentuese) ose nuk përmbush asnjë nga kriteret e mësipërme, do të vlerësohet me **0 pikë**.